



Departamenti për Monitorim

Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik

**Sistemi Gjyqësor në Mitrovicë/Mitrovica:
Shqetësimet e Vazhdueshme për të Drejtat e Njeriut
dhe Zhvillimet e fundit**

Raporti mujor - Dhjetor 2008

I. Hyrje

Dhjetori i 2008-ës shënoi muajin e dhjetë qëkur sistemi gjyqësor në regjionin Mitrovicë/Mitrovica pushoi së funksionuari në masë të gjerë.¹ Mungesa e sistemit të drejtësisë pengon seriozisht sundimin e ligjit dhe i kontribuon shkeljeve serioze të së drejtës për liri, të drejtës për qasje në drejtësi, dhe të drejtës për gjykim brenda kohës së arsyeshme.²

Në shtator 2008 UNMIK-u zyrtarisht shpalli planin e përbërë prej tri fazave për të rivendosur sistemin gjyqësor në regjion.³ Plani, edhe pse i vonuar në zbatimin e vet, është një zhvillim i mirëpritur. Megjithatë, ai nuk adreson mungesën e gjykatave të cilat trajtojnë rastet civile dhe rastet penale jo-urgjente.⁴ Shtrirja tash së voni në Mitrovicë/Mitrovica e gjykatësve dhe prokurorëve të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) mund të ndihmoj përmirësimin e situatës në të ardhmen e afërt.

II. Shkeljet e të drejtave të njeriut që rezultojnë nga mos-funksionimi i gjykatave

Përpos rasteve penale urgjente dhe disa ankesave penale të cilat ka mundësi që të shqyrtohen së shpejti në veri të Mitrovicës/Mitrovica,⁵ në dhjetor 2008 institucionet e mëposhtme kanë punuar me kapacitet të kufizuar ose aspak që nga 21 shkurti 2008:

- *Gjykatat e Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica.* Gjykata (që vepron përkohësisht në ndërtesën e Gjykatës Komunale në Vushtri/Vučitrn)⁶ adreson vetëm çështjet që kanë të bëjnë me paraburgim, ankesat mbi urdhrat për paraburgim dhe për vazhdimet e paraburgimit. Gjykata pranon disa parashtresa lidhur me padi civile por nuk cakton kurrfarë seance dhe nuk ndërmerr kurrfarë veprime tjera.

¹ Shih raportin e OSBE-së, *Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik, Reagimet ndaj shpalljes së pavarësisë së Kosovës ndikojnë seriozisht në sistemin e drejtësisë në Mitrovicë/Mitrovica dhe ndikojnë negativisht në gjykatat e regjioneve tjera, duke rezultuar me shkelje të të drejtave të njeriut.*

² Neni 5 dhe 6, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (tash e tutje Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut).

³ Mitrovicë/Mitrovica”, 3 tetor 2008, (“komunikata për shtyp e UNMIK-ut Nr. 1740”) e qasshme në [http://www.unmikonline.org/dpi/pressrelease.nsf/0/7DECCDA51DB11BE2C12574D70049E600/\\$FILE/pr1740.pdf](http://www.unmikonline.org/dpi/pressrelease.nsf/0/7DECCDA51DB11BE2C12574D70049E600/$FILE/pr1740.pdf)

⁴ Ka mundësi që të dëgjohen edhe disa raste të kundërvajtjeve, intervistë e OSBE-së me një zyrtar të Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut, 28 nëntor 2008.

⁵ Që nga dhjetori 2008, dhe krahas dëgjimit për paraburgim të mbajtur me 11 tetor 2008, OSBE nuk është në dijeni lidhur me ndonjë procedurë penale të ketë ndodhur në gjykatën e Mitrovicës/Mitrovica. Siç është raportuar, gjyqtarët ndërkombëtar janë ende duke “i seleksionuar se cilat raste do t’i dëgjojnë dhe duke identifikuar statusin e rasteve” (intervistë e OSBE-së me një zyrtar të Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut, 23 tetor 2008).

⁶ Duke filluar nga 21 shkurti 2008, një grup prej 50 deri në 200 protestues, në mes tyre edhe të punësuarit e sistemit gjyqësor të para-1999-ës, u mbledhën jashtë kompleksit të gjykatës në Mitrovicë/Mitrovica (Gjykata e Qarkut, Gjykata Komunale, Gjykata për Kundërvajtje dhe Prokuroria e Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica) në mëngjeset e ditëve të punës duke kërkuar që të hyjnë në ndërtesë dhe që ajo të i kthehet sistemit gjyqësor të Serbisë. Protestuesit hynë me forcë në ndërtesë me 14 mars 2008. Me 17 mars 2008 në një operacion të përkrahur nga KFOR-i, Policia e UNMIK-ut hyri në ndërtesë dhe arrestoi uzurpuesit. Trazira serioze civile pasuan të cilat quan në vdekjen e një polici civil ndërkombëtar.

- Gjykata Komunale në Mitrovicë/Mitrovica⁷ (që gjithashtu vepron përkohësisht në ndërtesën e Gjykatës Komunale në Vushtrri/Vuçitrn) adreson çështjet që kanë të bëjnë me paraburgim, ankesat mbi urdhrat për paraburgim dhe për vazhdimë të paraburgimit. Veç kësaj gjykata mban edhe seanca për konfirmim të aktakuzës në rastet ku i pandehuri ndodhet në paraburgim. Njëjtë si Gjykata e Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica, gjykata komunale pranon disa parashtrësia lidhur me padi civile por nuk cakton kurrfarë seance dhe nuk ndërmer kurrfarë veprime tjera.
- Zyra e legalizimeve në Gjykatën Komunale në Mitrovicë/Mitrovica dhe departamenti i gjykatës i cili lëshon certifikata mbi historinë penale punojnë dy ditë në javë në zyrat e Gjykatës Komunale në Vushtrri/Vuçitrn. Zyrat frekuentohen nga banorët e tërë regjionit, përfshirë këtu edhe serbët e Kosovës që jetojnë në veri të Mitrovicës/Mitrovica.
- *Prokuroria e Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica*.⁸ Prokurorët, duke punuar në ndërtesën e Gjykatës Komunale në Vushtrri/Vuçitrn, i kryejnë të gjitha punët deri në, dhe përfshirë edhe ngritjen e aktakuzës. Nuk mbahen seanca për konfirmim të aktakuzës në rastet që janë nën juridiksion të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica.
- *Prokuroria Komunale në Mitrovicë/Mitrovica*. Për rastet që bien nën juridiksion të Gjykatës Komunale në Mitrovicë/Mitrovica dhe ndodhin në Mitrovicë/Mitrovica jugore, prokurorët i kryejnë të gjitha punët deri në, dhe përfshirë edhe ngritjen e aktakuzës, dhe marrin pjesë në seancat për konfirmim të aktakuzës në rastet ku të pandehurit ndodhen në paraburgim. Për rastet e pandehura që ndodhin në Mitrovicë/Mitrovica veriore dhe Zvečan/Zveçan, prokurorët merren vetëm me rastet ku përfshihet paraburgimi. Prokurorët tentuan t'i adresojnë tre nga qindra vepra penale në Leposavić/Leposaviq dhe Zubin Potok. Megjithatë mungesa e gjykatave funksionale në ato komuna do të thotë se nuk mund të ketë ngritje të aktakuzave. Prokuroria Komunale e Mitrovicës/Mitrovica gjithashtu funksionon prej ndërtesës së Gjykatës Komunale në Vushtrri/Vuçitrn.
- *Gjykatat Komunale dhe për Kundërvajtje në Leposavić/Leposaviq dhe Zubin Potok*. Këto gjykata nuk janë duke funksionuar, përpos disa shërbimeve nga zyra e legalizimeve.⁹ Gjykata në Zubin Potok ka vërtetuar disa dokumente me vulë të UNMIK-ut që nga shkurti i 2008-ës.
- *Gjykata për Kundërvajtje në Mitrovicë/Mitrovica*¹⁰. Gjykata është duke punuar me kapacitet të kufizuar me lokacion të përkohshëm në Gjykatën Komunale në Vushtrri/Vuçitrn për incidentet që ndodhin në jug të Mitrovicës/Mitrovica. Megjithatë, gjykata për kundërvajtje nuk shqyrton asnjë rast që ka të bëjë me

⁷ Gjykata Komunale në Mitrovicë/Mitrovica ka poashtu juridiksion mbi Komunën e Zvečan/Zveçan.

⁸ Prokuroritë e qarkut dhe komunale në Mitrovicë/Mitrovica mbulojnë të gjitha komunat në regjion: Leposavić/Leposaviq, Mitrovicë/Mitrovica, Skenderaj/Srbica, Vushtrri/Vuçitrn, Zubin Potok dhe Zvečan/Zveçan.

⁹ Me 22 shkurt 2008, Ministria Serbe e Drejtësisë mori përsipër Gjykatat Komunale dhe ato për Kundërvajtje në Leposavić/Leposaviq dhe Zubin Potok. Gjykatat paralele në Kosovën veriore nuk duket të funksionojnë përpos disa vulosjeve të dokumenteve në disa raste.

¹⁰ Gjykata për Kundërvajtje në Mitrovicë/Mitrovica ka poashtu juridiksion mbi Komunën e Zvečan/Zveçan

incidente (siç janë tiketat e trafikut) që ndodhin në veri të Mitrovicës/Mitrovica dhe Zvečan/Zveçan.¹¹

A) E drejta për qasje në drejtësi

Sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, “Çdokush [ka] të drejtë që ta sjellë pranë gjykatës çfarëdo padie që ndërlidhet me të drejtat e tij civile.”¹² Gjykata po ashtu ka gjetur se “pengesa, qoftë edhe e karakterit të përkohshëm, mund të bie në kundërshtim me Konventën [Evropiane] [për të Drejtat e Njeriut].”¹³

Që nga 20 shkurti 2008, vetëm procedura minimale penale dhe për kundërvajtje janë mbajtur në regjionin që mbulohet nga Gjykatat Komunale dhe për Kundërvajtje në Mitrovicë/Mitrovica dhe nuk janë mbajtur procedura civile. Nuk ka pasur asnjë procedurë penale, civile ose për kundërvajtje në Zubin Potok, dhe Leposavić/Leposaviq.

Zbatimi i planit është hapi i parë për të korrigjuar këtë situatë. Megjithatë, qasja në drejtësi në gjykatat e sipërpërmendura akoma do të vazhdojë të mohohet në rastet civile, të kundërvajtjeve dhe rastet penale jo-urgjente.

Në veçanti, sa i përket rasteve civile, mungesa e funksionimit të gjykatave komunale në Mitrovicë/Mitrovica, Zubin Potok, dhe Leposavić/Leposaviq ndalon palët që të parashtrojnë padi civile, veprimet për kompensime të sigurimeve, rastet e punës, pengesa në posedim prone, trashëgimi,¹⁴ dhe kërkesa për urdhër mbrojtjeje për dhunë familjare,¹⁵ në mes padive tjera civile.

Veç kësaj, mungesa e gjykatës së qarkut ndalon që të parashtrohen ankesa kundër rasteve civile. Pasi që gjykatat civile të qarkut kanë gjithashtu juridiksion të shkallës së parë në disa lloje të kontesteve civile,¹⁶ banorët e tërë rajonit (përfshirë këtu edhe Skenderaj/Srbica dhe Vushtrri/Vučitrn) ndalohen që të parashtrojnë disa raste në gjykatën e qarkut siç janë shkurorëzimet, pronën intelektuale dhe disa raste të përkrahjes së bashkëshortëve, përkujdesjen e fëmijëve, rastet e atësisë.¹⁷

¹¹ Sipas informatave në dispozicion të OSBE-së, gjykata në Vushtrri/Vučitrn duket se shqyrton rastet në “procedurë të shkurtuar” dhe rastet urgjente, siç janë ato që nuk i përfshijnë seancat shqyrtuese dhe ato që përfshijn banorët që nuk janë nga Kosova. Shih nenin 201, Ligji mbi Kundërvajtjet, në Gazetën Zyrtare të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Nr. 23/1979.

¹² Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 4451/70, Aktgjykim, 21 shkurt 1975, paragrafi 36.

¹³ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Palaoro kundër Austrisë*, 16718/90, Aktgjykim, 23 tetor 1995, paragrafi 41.

¹⁴ Neni 26, Ligji mbi Gjykatat e Rregullta, Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës 21/1978.

¹⁵ Neni 5, Rregullorja e UNMIK-ut 2003/12 mbi Mbrojtjen kundër Dhunës Familjare, 9 maj 2003.

¹⁶ Neni 29, Ligji mbi Gjykatat e Rregullta, i plotësuar përmes Gazetës Zyrtare të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës 21/1978.

¹⁷ OSBE-ja, kryetarët e gjykatave të ndryshme të regjionit, dhe personeli regjional i gjykatës të gjithë kanë pranuar kërkesa, pyetje dhe ankesa nga individë të shqetësuar për shkak të pamundësisë së tyre për të pasur qasje në gjykata. Njerëzit posaçërisht kanë shprehur interes në parashtrimin e padive për shkurorëzim, urdhra për mbrojtje në rastet e dhunës shtëpiake, kërkesat për përkrahje të fëmijës dhe bashkëshortit, dhe zotimet civile.

B) E drejta për gjykim brenda kohës së arsyeshme

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut i garanton secilit të drejtën në gjykim brenda kohës së arsyeshme.¹⁸ “Trazirat publike” në një regjion ku është mbajtur gjykimi mund të ishin arsyetim valid për vonesa në procedurë por vetëm për aq kohë derisa autoritete publike të marrin hapa për të transferuar ngarkesën e punës në ndonjë juridiksion tjetër.¹⁹ Në fakt, autoritetet publike kanë për detyrë të organizojnë sistemet e tyre të drejtësisë që t’i mundësojnë gjykatave të punojnë në përputhje me kushtin e “kohës së arsyeshme”.²⁰

Ndërprerja e aktiviteteve gjyqësore në Mitrovicë/Mitrovica, Leposavić/Leposaviq, dhe Zubin Potok ka qar në vonesa dhe në pezullime të menjëhershme të procedurave civile dhe penale që implikojnë të drejtën për gjykim brenda kohës së arsyeshme.²¹ Kjo është veçanërisht shqetësuese në rastet ku nevojitet urgjenca speciale siç janë urdhrat për mbrojtje në rastet e dhunës shtëpiake ose rastet kundër të dyshuarve që ndodhen në paraburgim.

Në rastet penale, prokurorët kanë ngritur aktakuza, por në të shumtën e rasteve, seancat për konfirmim nuk janë mbajtur brenda afatit kohor të përcaktuar me Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale.²² Në dhjetor 2008, ka së paku 61 raste penale për veprat që kanë ndodhur me ose pas 21 shkurtit 2008 dhe të cilat bien nën juridiksion të Gjykatave të Qarkut dhe atyre Komunale në Mitrovicë/Mitrovica dhe të cilat janë në pritje të konfirmimit të aktakuzës.²³ Veç kësaj, një numër rastesh që kanë ndodhur para 21 shkurtit 2008 janë po ashtu në pritje të konfirmimit të aktakuzës. Rasti në vijim shërben si shembull:

Me 26 maj 2008 prokurori i qarkut në Mitrovicë/Mitrovica ngriti aktakuzë kundër një polici shqiptar të Kosovës duke e akuzuar atë me vrasje të rëndë në tentativë.²⁴ posedim, kontroll, ose shfrytëzim të

¹⁸ Neni 6(1), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

¹⁹ Shih Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Foti kundër Italisë*, 7604/76, 7719/76, 7781/77 dhe 7913/77, Aktgjykim, 10 dhjetor 1982, paragrafi 61.

²⁰ Shih, p.sh, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Eckle kundër Gjermanisë*, 8130/78, aktgjykim, 15 korrik 1982, paragrafi 92. Në një rast tjetër gjykata gjeti se “një zmbropsje e përkohshme nga puna nuk përfshin përgjegjësi në barrë të Shteteve Kontraktuese po që se ato marrin, me shpejtësi të duhur, veprime korrigjuese për të vepruar me një situatë të jashtëzakonshme” (Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Milasi kundër Italisë*, 10527/83, Aktgjykim, 25 qershor 1987, paragrafi 18).

²¹ Këto vonesa gjithashtu ndikojnë në gjykatat për kundërvajtje. Veçanërisht shqetësuese është se, personave të cilëve iu është konfiskuar përkohësisht patentë-shoferi ose pasaporta për të siguruar pagesën e gjobës nuk mund t’i marrin këto dokumente. Edhe po që se ata kanë dashur ta paguajnë gjobën, nuk kanë mundur ta bëjnë këtë për shkak se nuk kanë pasur qasje në gjykatë. Gjyqtarët e gjykatës për kundërvajtje nuk kanë qasje në zyrat e tyre andaj nuk kanë mundur t’ua kthejnë këto dokumente pronarëve të ligjshëm të tyre.

²² Ligji kërkon nga gjykatat që të caktojnë konfirmimin e aktakuzës menjëherë dhe jo më vonë se dy muaj nga data kur është ngritur aktakuza. Nenet 309(1) dhe 312(2), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/26, 6 korrik 2003 (“Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale”).

²³ Numri i rasteve që bien nën juridiksionin e Gjykatave Komunale në Zubin Potok dhe Leposavić/Leposaviq nuk ishin në dispozicion.

²⁴ Neni 147, Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut 2003/25, 6 korrik 2003 (“Kodi i Përkohshëm Penal”).

paautorizuar të armëve:²⁵ marrje të ryshfetit:²⁶ shpërdorim të autoritetit ose pozitës zyrtare:²⁷ mashtrim:²⁸ dhe dy pika të keqtrajtimit gjatë kryerjes së detyrave:²⁹ Seanca për konfirmim ka mbetur të caktotet. I pandehuri fillimisht ishte mbajtur në paraburgim pre 12 marsit deri me 26 maj 2008. Pastaj ai ishte liruar dhe nga ai tanimë kërkohet që të paraqitet rregullisht në stacionin e policisë.

Mosfeksionimi i gjykatave gjithashtu ka quar në vonesa të lëndëve civile, duke implikuar të drejtën e palëve për gjykim brenda kohës së arsyeshme:

Në një rast të iniciuar në maj të vitit 2003, paditësit kishin kërkuar që të iu vërtetohet pronësia mbi një pronë që gjendet ne Mitrovicë/Mitrovica. Pa kërkuar fare të paditurit, gjykata caktoi një përfaqësues të përkohshëm dhe në fund vendosi në favor të paditësve. Të paditurit, të cilët po jetonin dhe punonin në Mitrovicë/Mitrovica dhe Zvečan/Zvečan gjatë tërë kohës, morën vesh për vendimin dhe parashtruan një propozim për rigjykim. Në nëntor të 2007-ës, gjykata aprovoi propozimin e të paditurve. Nuk ka pasur kurrfarë seance dëgjimore dhe rasti është ndalur për shkak të mosfeksionimit të Gjykatës Komunale në Mitrovicë/Mitrovica. Në maj të vitit 2008, OSBE-ja bisedoi me një nga të paditurit i cili nuk kishte dëgjuar asgjë lidhur me rastin e tij.

Vendosja e gjyqtarëve te EULEX-it të ngarkuar për të trajtuar rastet civile mund te ndihmon në të ardhmen, por tani për tani cenimet serioze vazhdojnë. Një sistem i drejtësisë krejtësisht funksional është esencial për mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit.

C) E drejta për liri

Ligji i Kosovës përcakton afate për paraburgim, i cili së pari duhet të legalizohet dhe pastaj në mënyrë periodike të ri-shqyrtohet nga gjykata kompetente.³⁰ Për të arsyetuar paraburgimin e vazhduar ndaj një të dyshuari, autoritetet publike duhet jo vetëm të dëshmojnë se bazat për këtë vazhdojnë të ekzistojnë por gjithashtu të zbatojnë “përkushtim të veçantë” gjatë rrjedhës së procedurës.³¹ Në të kundërtën, paraburgimi bëhet i paligjshëm dhe personi duhet liruar në pritje të gjykimit.³² Në fakt, autoritetet publike duhet të sigurojnë që paraburgimi i personit të mos zgjasë më shumë se që është e duhur.³³ Sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, shtetet kanë për detyrë të organizojnë sistemet e tyre ligjore në atë mënyrë që t’i mundësojnë

²⁵ Id. Neni 328(2).

²⁶ Id. Neni 343.

²⁷ Id. Neni 339.

²⁸ Id. Neni 261.

²⁹ Id. Neni 164.

³⁰ Neni 212(4), dhe neni 284 - 287, Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale.

³¹ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Dobrev kundër Bullgarisë*, 55389/00, Aktgjykim, 10 gusht 2006, paragrafi 79.

³² Shih nenet 5(1)(c) dhe 5(3), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

³³ “Vazhdimi i paraburgimit mund të justifikohet në ndonjë rast të veçantë në qoftë se ka tregues specifik të kërkesës së vërtetë nga interesi i publikut i cili, pa lënë anash prezumimin e pafajësisë, tejkalon rregullin e respektit për lirinë e individit” (Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Labita kundër Italisë*, 26772/95, Aktgjykim, 6 prill 2000, paragrafi 152.

gjykatave të punojnë në përputhje me të drejtën për gjykim brenda kohës së arsyeshme.³⁴ Kur të përballet me zmbarsje të përkohshme nga puna, autoritetet publike duhet të marrin me shpejtësinë e duhur, veprime korrigjuese që të trajtojnë situata të jashtëzakonshme të llojit të tillë.³⁵

Prej 20 deri me 27 shkurt 2008, Gjykata e Qarkut dhe Gjykatat Komunale në Mitrovicë/Mitrovica nuk kanë mundur të dëgjojnë asnjë çështje që ka të bëjë me paraburgim. Gjatë asaj kohe së paku dy të dyshuar janë liruar nga paraburgimi për shkak se urdhri për paraburgim të tyre kishte skaduar.³⁶ Gjykatat e Qarkut dhe Komunale në Mitrovicë/Mitrovica filluan të mbajnë dëgjime për paraburgim në ndërtesën e Gjykatës Komunale në Vushtrri/Vučitrn, me 27 shkurt 2008.³⁷

OSBE ka monitoruar raste në të cilat Gjykata e Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica ka vazhduar paraburgimin e të pandehurit *inter alia* sepse prokurori, për shkak të mos-funksionimit të gjykatave nuk ka mundur të vazhdojë hetimet kundër të dyshuarit:

Me 12 mars 2008, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica vazhdoi paraburgimin kundër një të pandehuri të dyshuar për kryerje të rastit të rëndë të vjedhjes në formë të plaçkitjes.³⁸ Në mes të arsyeve për vazhdim të paraburgimit, gjykata mori parasysh faktin se disa dëshmitarë nuk mund të dëgjohej pasi që “prej 17 shkurtit 2008 puna në Prokurorinë e Qarkut nuk mund të kryhet në mënyrë të rregullt.” I pandehuri ka qenë në paraburgim që nga dhjetori i 2007-ës.

Në një tjetër rast pranë Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica, një i pandehur i akuzuar për vrasje të rëndë,³⁹ vrasje në tentativë;⁴⁰ dhe posedim, kontroll ose përdorim të paautorizuar të armëve⁴¹ ka qenë në paraburgim që nga 6 shkurti 2007. Gjykimi i tij ishte në fazën përfundimtare kur gjykata ndaloi së funksionuari, por që nga ajo kohë nuk ka pasur kurrfarë zhvillimi. Gjykata shtyu paraburgimin kundër tij deri me 3 janar 2009.

Gjithashtu pranë Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica një i pandehur i akuzuar për vrasje⁴² dhe posedim, kontroll ose përdorim të paautorizuar të armëve⁴³ ndodhet në paraburgim që nga 31 maji 2007. Deri në kohën kur gjykatat ndaluan së funksionuari, gjykimi i tij nuk kishte filluar. Gjykata vazhdoi paraburgimin kundër tij deri me 11 janar 2009. Mungesa e gjykatave plotësisht funksionale i ka kontribuar vonesave në këtë rast.

³⁴ Neni 5 (3), dhe 6 (1), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Shih *Spentzouris kundër Greqisë*, 47891/99, Aktgjykim, 7 maj 2002, paragrafi 27.

³⁵ Shih *Baggetta kundër Italisë*, 10256/83, Aktgjykim, 25 korrik 1987, paragrafi 23.

³⁶ Intervistë e OSBE-së me një avokat, 20 mars 2008. Dy të paraburgosurit të dyshuar për kidnapim ishin liruar me 22 shkurt 2008.

³⁷ Kjo përfshin dy dëgjimet brenda 72 orëve nga arresti fillestar dhe dëgjimet për të vendosur mbi vazhdimet e urdhrave për paraburgim. Për të ju shmangur lirimit të personave që aktualisht mbahen në paraburgim, disa gjyqtarë nga Mitrovicë/Mitrovica mbajtën seanca në qendrën e paraburgimit në Lipjan/Lipljane.

³⁸ Neni 256(1), lidhur me Nenin 255 (1), Kodi i Përkohshëm Penal.

³⁹ Neni 147, Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës.

⁴⁰ Id. nenet 146 dhe 23.

⁴¹ Id. neni 328(2).

⁴² Id. neni 146.

⁴³ Id. neni 382(2).

Me paraqitjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar të UNMIK-ut, shkeljet e të drejtës për liri në disa nga këto raste mund të korrigjohen. Megjithatë, rastet e pezulluara që përfshijnë të pandehur jo-serb të Kosovës nuk do të dëgjohen. Veç kësaj, personeli i kufizuar ndërkombëtar nuk mund të sigurojë se do të ketë progres në të gjitha rastet kundër serbëve të Kosovës.

D) Efektet tjera negative në sundimin e ligjit

Mungesa e gjykatave funksionale në veri të Kosovës ka tjera efekte negative në sundimin e ligjit.

Për shembull, individët të cilët kanë marr vendime civile që parashohin gjobë, nuk mund t'i ekzekutojnë ato për shkak se nuk ka gjykatë e cila do t'i detyrojë debitorët nga vendimet që të paguajnë. Rasti në vijim shërben si shembull:

Në një rast pranë Gjykatës Komunale në Leposavić/Leposaviq, një paditëse serbe e Kosovës, fitoi në procedurë për dëmtime të banesës së saj të shkaktuara nga rrjedhja e ujit në banesën e të paditurit. Pasi që paditësja inicioi procedurën përmbartimore, i padituri pagoi borxhin në gjykatë me rata mujore. Paditësja refuzoi të pranojë pagesën derisa të mos deponohet e tërë shuma. Në ndërkohë, gjykata pushoi së funksionuari. Në korrik 2008, OSBE-ja bisedoi me paditësen e cila tha se nuk ka marr asnjë nga paratë që i janë borxh asaj.

Veç kësaj, gjykatat jo-funksionale kanë penguar zbatimin e ligjit duke ndaluar zënien dhe paraburgimin e të arratisurve:

Në shator të hershëm të 2008-ës, autoritetet kishin zënë dhe parandaluar një individ i cili ka qenë i dënuar por jo edhe i burgosur sipas vendimit për dënim. Vetëm pak pas kësaj, policia e liroi personin sepse burgu nuk e pranonte atë pa aktgjykimin zyrtar kundër tij, i cili mbeti në shkresat e lëndës në ndërtesën e gjykatës në Mitrovicës/Mitrovica.

III. Plani i ndarë në tri faza për të dëgjuar disa lëndë penale në veri të Mitrovicës/Mitrovica

Plani i UNMIK-ut për të rivendosur sistemin gjyqësor në regjion ka tri faza.⁴⁴ Faza e parë e planit që filloi me 3 tetor 2008 dhe që pritej të zgjasë përafërsisht 60 ditë,⁴⁵ në dhjetor 2008 nuk ka përfunduar ende. Gjatë kësaj faze, është paraparë që gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtar do të zhvillojnë procedurat në “rastet urgjente penale” në Mitrovicë/Mitrovica veriore duke shfrytëzuar “procedurat dhe ligjet e UNMIK-ut.”⁴⁶ Rastet civile “nuk do të dëgjohen.”⁴⁷ Gjatë fazës së parë, UNMIK-u dhe përfaqësuesit serb kanë pasur për qëllim të vazhdojnë diskutimet teknike lidhur me implementimin

⁴⁴ UNMIK/PR/1740

⁴⁵ Intervista e OSBE-së me një zyrtar nga Departamenti i Drejtësisë së UNMIK-ut, me 23 tetor dhe me 28 nëntor 2008.

⁴⁶ Id.

⁴⁷ Id.

e fazave të ardhshme.⁴⁸ Fatkeqësisht, deri në dhjetor 2008 shume pak veprime janë marr në secilin rast penal.

Faza e dytë parashih hyrjen e personelit vendor gjyqësor duke rritur kështu “kapacitetin e gjykatës për të trajtuar më shumë raste.”⁴⁹ Ka pasur pak komente të drejtpërdrejta publike lidhur me fazën e tretë por me sa duket kjo ka të bëjë me “tërheqjen e ndërkombëtarëve.”⁵⁰ Plani nuk është përfundimtar dhe do të adaptohet qoftë se lindin probleme ose vjen tek ndryshimi i situatës në terren.

Për momentin, zbatimi vetëm i ligjit penal dhe procedurës civile të UNMIK-ut nuk do të duhej të shkaktonte ndonjë problem të madh sepse kodi penal dhe kodi i procedurës penale në Kosovë janë rregullore të UNMIK-ut dhe zbatohen në të gjitha gjykatat e Kosovës.⁵¹ Megjithatë, po që se ndonjë ligj i ri penal të miratohet (siç është mundësia për ligjin mbi mbrojtjen e dëshmitarëve) ose të këtë ndryshime të kodit të përkohshëm penal ose të kodit të procedurës penale nga Asambleja e Kosovës, pa nënshkrimin e PSSP-së, mund të qoj në konflikte.

Megjithatë, OSBE është e brengosur me raportimet se gjykata fillimisht do t’i trajtojë vetëm rastet që përfshijnë të pandehur serb të Kosovës.⁵² Si pasojë, të pandehurit shqiptarë të Kosovës do të qëndrojnë më gjatë në paraburgim se sa të pandehurit serb, pasi që rastet e tyre nuk do të shkojnë përpara. Seleksionimi se cilat raste do të dëgjohen, bazuar në përkatësinë etnike të të pandehurit ngrit shqetësime lidhur me barazi para ligjit.⁵³

Veç kësaj, UNMIK-u deklaroi publikisht se vetëm rastet “urgjente” do të adresohen.⁵⁴ Pasi që “urgjent” nuk është definuar, gjyqtarët dhe prokurorët do të kenë diskrecion të gjerë, madje edhe të tepërt, në seleksionimin e rasteve.

Kriteri për seleksionimin e rasteve duhet të jetë transparent, i zbuluar publikisht dhe i definuar ngushtë, për të ngritur besimin e publikut për procedurë.

⁴⁸ Shpallje, Ministria Serbe e Drejtësisë (18 shtator 2008) e qasshme në www.mpravde.sr.gov.yu/cr/nees/vesti/sud-u-mitrovici-pocinje-sa-radom-pocetkom-oktobra.html, sipas së cilës “Gjatë kësaj periudhe bisedimet teknike me UNMIK-un lidhur me përfshirjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve vendor në punën e sistemit të drejtësisë pas afatit prej 60 ditëve do të vazhdojnë” (përkthim jozyrtar i OSBE-së). Shih gjithashtu komunikatën për shtyp të UNMIK-ut Nr. 1740 (“UNMIK-u për momentin është duke mbajtur diskutime me partnerët relevant në mënyrë që të përshpejtojë lëvizjet drejt fazës së ardhshme.”)

⁴⁹ UNMIK/PR/1740.

⁵⁰ Komentet e Zëvendës Përfaqësuesit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm, David Harland, “Dialogu ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës-Gjyqësori dhe Policia” (29 shtator 2008) Media Centre Čačalic/Čačavica, e qasshme në <http://www.medijacentar.org/modules.php?name=Content&pa=showpage&pid=165>.

⁵¹ Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/25, 6 korrik 2003 (“Kodi i Përkohshëm Penal”); Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/26, 6 korrik 2003 (“Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës”).

⁵² Intervista me një zyrtar të UNMIK-ut, 14 tetor 2008. Çështjet e sigurisë ishin ngritur si një nga arsytet që mund të ndalojnë që shqiptarët e Kosovës për momentin të gjykohen në veri të Mitrovicës/Mitrovica.

⁵³ Neni 14 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut thotë: “Gëzimi i të drejtave dhe lirive të parapara në këtë Konventë duhet të sigurohet pa diskriminim mbi çfarëdo baze siç janë gjinia, raca, gjuha, religjioni, mendimi politik apo ndonjë tjetër, origjina nacionale ose shoqërore, asociimi me ndonjë minoritet nacional, prona, lindja apo ndonjë tjetër.”

⁵⁴ UNMIK/PR/1740.

Sipas informatave në dispozicion të OSBE-së, rastet në të cilat i pandehuri gjendet në paraburgim do të kenë prioritet.⁵⁵ Megjithatë, në dhjetor 2008 ka 56 persona që ndodhen aktualisht në paraburgim (përveç 26 personave që janë në arrest shtëpiak)⁵⁶, dhe vetëm një numër i vogël i gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar,⁵⁷ jo të gjitha rastet do të mund të dëgjohen shpejtë.

Për më tepër, autoritetet relevante duhet të marrin parasysh çështjet në vijim që kanë të bëjnë me ri-hapjen e gjykatës:

- Pasi që situata e sigurisë mund t'i bëjë dëshmitarët, përpos atyre serb të Kosovës, të hezitojnë të udhëtojnë në veri, të pandehurit në procedura pranë gjyqtarëve ndërkombëtar mund të ndalohen të ftojnë dëshmitarë në mbrojtje të tyre.⁵⁸
- Rrethanat e sigurisë së shtuar në ndërtesën e gjykatës në veri të Mitrovicës/Mitrovica mund të implikojnë të drejtën për gjykim publik.⁵⁹ Gjyqtarët ndërkombëtar duhet po ashtu të sigurojnë që vendimet të shpallen në mënyrë publike.⁶⁰
- Është me rëndësi që të gjithë komunitetet në Kosovë të kenë qasje në gjykatë, që gjykata të dëgjojë rastet ku përfshihen të gjitha komunitetet e Kosovës, dhe që personeli i gjykatës të ofrojë shërbimin e përkthimit për të gjitha gjuhët relevante në Kosovë (përfshirë gjuhën shqipe dhe atë serbe) kur është e domosdoshme për dëshmitarë dhe palë.
- Numri i vogël i gjyqtarëve ndërkombëtar që janë caktuar të punojnë në gjykatë vështirëson përbërjen e kolegjeve pasi që gjyqtarët që marrin pjesë në fazat e hershme të procedurës mund të diskualifikohen nga procedurat e mëvonshme. Nëse i njëjti gjyqtar merr pjesë në fazat e ndryshme të procedurës, mund të kemi shkelje të kodit të përkohshëm të procedurës penale (dhe po ashtu të së drejtës për gjykatë të paanshme ose/dhe gjykatë të themeluar sipas ligjit).⁶¹ Rrjedhimisht, numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve do të duhet të rritet.

⁵⁵ Ligji vendor përcakton se gjykatat duhet të veprojnë me urgjencë të veçantë kur i dyshuari mbahet në paraburgim (shih nenet 279(2) dhe 463(4), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale).

⁵⁶ Këto statistika janë për rastet që bien nën juridiksion të Gjykatave Komunale dhe të Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica.

⁵⁷ Sipas informatave në dispozicion të OSBE-së, që të pesë gjyqtarët ndërkombëtar të cilët aktualisht punojnë në Departamentin e Drejtësisë së UNMIK-ut, si shtesë e së paku tre prokurorëve ndërkombëtar janë caktuar të punojnë me ndërrime në Mitrovicë/Mitrovica.

⁵⁸ Shih nenin 6(3)(d), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ngjashëm, palët e dëmtuara jo-serbe mund të parandalohen që të dëshmojnë kundër të pandehurve dhe/ose të propozojnë dëshmitarë (shih nenin 80, Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale).

⁵⁹ Shih nenin 6(1), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Edhe pse Konventa parasheh "sigurinë nacionale" si një nga bazat që kufizojnë publicitetin e gjykimit, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka interpretuar në mënyrë të kufizuar këtë përjashtim duke thënë se "problemet me siguri janë veti të zakonshme në shumë procedura penale, por rastet në të cilat shqetësimet për siguri arsyetojnë përjashtimin e publikut nga gjykimi megjithatë janë të rralla" (shih *Riepan kundër Austrisë*, 35115/97, Aktgjykim, 14 nëntor 2000, paragrafi 34).

⁶⁰ Shih neni 6(1), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

⁶¹ Shih nenin 40, Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale, dhe nenin 6(1), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Shih gjithashtu Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Hauschildt kundër Danimarkës*, 10486/83, Aktgjykim, 24 maj 1989, paragrafët 48-53, dhe *Fey kundër Austrisë*, 14396/88, Aktgjykim, 24 shkurt 1993, paragrafët 30-36.

Në përmbledhje, plani i ri i UNMIK-ut është premtues dhe shumë i vonuar. Megjithatë, nuk korrighon sistemin e paralizuar të drejtësisë civile në tërë regjionin Mitrovicë/Mitrovica, dhe shumica dërmuese e rasteve penale nuk do të dëgjohen. Shtrirja e EULEX-it deri diku mund të përmirësoj situatën. Brenda kohës së raportimit, është e paqartë shtrirja brenda cilës EULEX-i do të jetë në mundësi të merret me rastet që shfaqen në komunat veriore në Leposavić/Leposaviq, Zubin Potok dhe Zvečan/Zveçan. Andaj, OSBE është i shqetësuar se shkeljet e të drejtave të njeriut që ndërliidhen me mos-funksionimin e gjykatave, mund të vazhdojnë.

IV. Përfundim

Mungesa e një sistemi funksional gjyqësor në Kosovën veriore ka quar në shkelje serioze të të drejtave të njeriut përfshirë këtu të drejtën për qasje në drejtësi, të drejtën për gjykim brenda kohës së arsyeshme, dhe të drejtën për liri. Përderisa plani i cili fillimisht ofron që gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtar të trajtojnë rastet urgjente penale është premtues, prapëseprapë i njëjti nuk adreson sistemin gjyqësor të paralizuar civil dhe shumicën e rasteve të pezulluara penale. Përderisa vazhdon implementimi i planit të ndarë në tri faza, OSBE thekson domosdoshmërinë për një sistem të drejtësisë penale dhe civile funksional, dhe multi-etnik në regjionin Mitrovicë/Mitrovica, sa më shpejt që është e mundur.